

Në 600-vjetorin e lindjes së Gjergj Gjon Kastriotit

Figura e Skënderbeut në veprat e Gjeçovit

Padyshim se Atë Shtjefën Gjeçovi më shumë se kushdo nga krijuesit tjerë iu kushtua veprimtarisë së Gjergj Kastriotit. Ai shkroi poezi, studime shkencore e drama kushtuar kryeheroit tonë kombëtar. Atë Gjeçovi e bleu edhe kambanën e Kishës së Kështjellës së Gjergj Kastriotit, e cila edhe sot ruhet në Muzeun e Krujës

Shkruan: **Frrok KRISTAJ**

Studiuesit e jetës dhe të veprës së Atë Shtjefën Gjeçovit e kanë konsideruar figurën e tij si njërin ndër më të ndritshmet dhe më të shquarat e historisë dhe të kulturës sonë kombëtare. Pra, figura e Shtjefën Gjeçovit është konsideruar dhe vazhdon të konsiderohet njëra ndër shembëlltyrat më të shkëlqyera për t'i ruajtur, ringjallur dhe për t'i bërë të pavdekshme visaret popullore që kanë vlera të jashtëzakonshme. Atë Shtjefën Gjeçovi, që u lind (më 12 korrik 1874) në Janjevë, kurse u vra nga pushteti serb (më 14 tetor 1929) në Zym të Hasit të Thatë, ishte meshtar, mësues, arkeolog, speleolog, njohës i sociologjisë familjare, etnograf, mbledhës i palodhshëm i folklorit, krijues letrar, poet, dramaturg, përkthyes, publicist dhe atdhetar i përkushtuar. Trashëgimia e tij letrare-shkencore, që ka mbi 10 mijë faqe materiale të shkruara me tematikë të nduarndurtë, është ndër më të rrallat në historinë e kulturës, por edhe të mendimit shqiptar. Për këtë kontribut të rrallë ai u nderua me titullin "Honoris caussa" nga Universiteti i Lajpcigut të Gjermanisë.

Duke shpalosur figurën dhe veprimtarinë e të madhit Gjeçov, shpalosim aspekte të identitetit tonë kombëtar dhe rrënjët e thella të kulturës sonë, që na i përkujton kapitujt më tragjikë, por edhe më krenarë të historisë sonë kombëtare. Lista e shkrimeve të tij të publikuara e në dorëshkrim, por edhe e eksponateve (arkeologjike e etnografike), është shumë e gjatë.

Përndryshe, Atë Shtjefën Gjeçovi, apo "shqiptari më interesant" siç e kishte quajtur Faik Konica, krahas krijimtarisë letrare, historike, gjuhësore, etnografike, folklorike, është ndër shqiptarët e parë që e ngriti zërin kundër vjedhjeve të pasurisë kulturore e arkeologjike nga pushtuesit serbomalazezë. Nga ky koleksionist, ato objekte, eksponate apo shkrime, që i shpëtuan rrebesheve të kohës, sot renditen në fondin e artë të trashëgimisë tonë kulturore, siç ishte rasti edhe me kambanën e Kishës së Shën Andreas të Kështjellës së Krujës.

Gjeçovi bleu kambanën e kishës së Gjergj Kastriotit

Në fakt, në vitin 1900 konsulli frances i Shkodrës botoi një udhëpërshkrim, ku bënte fjalë edhe për dy kambana kishtare, që ishin të lëna në mëshirën e fatit në rrënojat e Kishës brenda mureve rrethuese të Kështjellës së Krujës. Njëra nga këto kambana ishte bashkëkohëse me epokën e lavdishme të Gjergj Kastriotit. Ajo ishte e derdhur në bronc me përzierje metalesh të çmuara. Me të kuptuar për këtë kambanë u vunë në lëvizje tregtarët e relikteve e antikuareve për çka iu propozua agait të qytetit të Krujës Muharrem Kaloshit shuma prej 25 napolonash flori me kusht që ta dërgonte kambanën e Skënderbeut në Barbullush. Kjo sipas trafikantëve ishte rruga më e shkurtër, sepse edhe

në kohën e pushtimit turk ekspozate të tilla nuk dilnin lehtë nga portat e doganat e Perandorisë. I informuar mirë për këtë Gjeçovi, që ishte atëbotë meshtar në Laç të Kurbinut i rreket punës për ta futur në dorë këtë relik të çmuar, në mënyrë që t'i trashëgohet shqiptarëve si ekspozatë i kohës së epokës së lavdishme të Gjergj Kastriotit. Gjeçovi shkon te Muharrem Aga me të cilin hynë në pazar dhe bie në dakort për një çmim prej 15 napolonash, por që këmbanën ta marrë nga Kruja vet Gjeçovi. Se si i sajoi Gjeçovi 15 napolona nuk dihet, por vet ai më 1901 shkruan: "... unë nuk mund ta paguaj edhe sikur ta shisja vetën time". Megjithatë ai e bleu kambanën, të cilën edhe e fsheu mirë. Më pas i shkroi konsullit Austro-Hungarez në Durrës, prej të cilit kërkonte instruksione. Më të u pajtuan dhe lidhën kontratë që kambanën ta ruante konti austriak Kiuatkowski, për ta ruajtur, përkatësisht për ta kthyer nga Vjena kur të ndërtohet Kisha e Kështjellës së Krujës. Kambana udhëtoi drejtë Durrësit e më vonë drejt Vjenës. Dhe, më 28 nëntor të vitit 1923, kur u hap për herë të parë Muzeu Kombëtar Shqiptar, Gjeçovi e ngrit në këmbë me letra Qeverinë e Vjenës, por edhe Ambasadën e tyre (Austriisë) deri sa ia arriti qëllimit. Kambana megjithatë me vonesë u kthye. Nga Vjena iu dërgua Ambasadës së Shqipërisë në Romë dhe në dhjetor të vitit 1923 arriti në Tiranë. Me të kuptuar për këtë Gjeçovi nga Shkodra shkon në Tiranë për t'u bindur se a është po ajo kambanë që e kishte blerë ai. Me atë rast Gjeçovi e vizatoi (korrik 1924) kambanën në dy pamje, skica këto që edhe sot ruhen në Arkivin Qendror Historik të Shqipërisë në Tiranë. Megjithatë, odisejada e kambanës nuk përfundon me kaq, sepse Muzeu i Tiranës shkatërrohet për çka Gjeçovi shkon në Tiranë dhe e merr kambanën, të cilën e dërgon në Shkodër ku qëndron deri pas Luftës së Dytë Botërore për t'u kthyer prapë në Tiranë, kurse tash ajo kambanë ruhet në Muzeun Kombëtar të Gjergj Kastriotit – Skendërbeut në Krujë.

Gjeçovi shkroi edhe poezi, drama e studime kushtuar Skendërbeut

Njëherësh, Atë Shtjefën Gjeçovi në katër numra të revistës "Albania" (Shkodër 1905-1906 ka botuar edhe 16 tregime e gojëdhëna të ndryshme kushtuar Gjergj Kastriotit, të cilat vet Gjeçovi i kishte mbledhur në Laç dhe fshatrat tjera të Kurbinut të Krujës, e të cilat paraqitnin gojëdhënat e para të mbledhura për Gjergj Kastriotin, përkatësisht ato ishin mbledhur 21 vjet para botimit të Marin Sirdanit "Skënderbeu sipas gojëdhënash" botuar në vitin 1926 dhe 60 vjet para se të bëhej mbledhja sistematike e krejt gojëdhënave e këngëve që flasin për Gjergj Kastriotin dhe për kohën e tij, që e bëri Instituti i Folklorit të Tiranës, duke botuar blenin "Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun", Tiranë, 1967. Gjeçovi kishte mbledhur edhe 50 përralla, tregime e gjëdhëna të ndryshme, 16 prej të cilave që lidheshin me Gjergj Kastriotin, të cilat i kishte botuar në revistën "Albania", kurse pas Luftës së Dytë Botërore ato përsëri ishin botuar në vëllimin "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar", Tiranë, 1959, vëllimi III. Të themi edhe këtë se në "Vepra II", faqe 198-209, të kompletit të Gjeçovit, "Vepra 1-4", Prishtinë, 1987, janë të rënditura 16 gojëdhëna për Gjergj Kastriotin, si: "Mullini Fall n'Hurdhaz (Kurbi)", "Mali Skënderbeg n'katun t'Vinjallit n'Kurbi", "Kroi Skendërbeg", "Gurr Mamica", "Buza e Skendërbegut", "Poçi i venës n'shpi t'Malçaive n'katun t'Skurait n'Kurbi", "Diëja e Kok Malçit", "Nji pleqni e dame prej Skendërbegut e Kok Malçit e gjoba e marrun për openga", "Vrasa e Ballaban pashës, mas popullit", "Vojsava, Mamica, Hasan aga e Skendërbeu", "Gjelat e Tiranës t'namun prej Skendërbeut", "Kuveni i Gjergj Kastriotit e i Lekë Dukagjinit", "Skendërbegu me treqin ushtarë

n'Nërshez", "Skendërbegu n'katun t'Shebës, n'Thcellë t'epër n'shpi t'Gjikajve" dhe "Kalaja e Skendërbegut".

Atë Shtjefën Gjeçovi që sipas Faik Konicës ishte "nji nga njerëzit më të lartë që ka pasur Shqipëria", shkroi edhe 21 poezi, pesë prej të cilave ia kishte kushtuar kryeheroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit ("Hiria e Gjergj Kastriotit" apo Ligjeratë Lkenit të Hasit me Gjergj Kastriotin, "Pse!?", "Kuvendime", "Tingllim" dhe "E drejta").

Në anën tjetër, Atë Shtjefën Gjeçovi krahas punës për krijimin e bazës materiale të historisë kombëtare, u përpoq që të sstudiojë edhe disa periudha të saj e sidomos nga koha e lashtë. Kështu, në vitin 1914 ai botoi studimin "Përkrenarja e Skënderbeut" ("Hylli i Dritës", numër 7, 1914, faqe 218-221), pastaj dramën "Shqyptari ngadhnyes" (dramë në vargje sipas ngjarjes së viteve 1443-1447 e që i kushtohet prindërve të Gjergj Kastriotit, pra Gjon Kastriotit) por e shkruar gjatë viteve 1902-1904 (dorëshkrimi ruhet në AQH të Shqipërisë, fondi 58, dosja 34, dokumenti 1-39), "Dashtnija e Atdheut" (1901), që iu kushtua po ashtu Gjergj Kastriotit (dorëshkrimi ruhet në AQH të Shqipërisë, fondi 58, dosja 44), pastaj "Jeta e Skanderbegut", shkrimin historik "Kulshedra e Arbnis – Gjergj Kastriotit Krutanit", "Princi i dy Dibrave", që i kushtohet bashkëluftëtarit të Gjergj Kastriotit - Moisi Golemit (dorëshkrimi jo i plotë ruhet në Arkivin Qendror Historik të Shqipërisë, fondi 58, dosja 45) e kështu me radhë. Nga veprat e cituara, por edhe të tjerat, del qartë se Gjeçovi një pjesë mjaft të mirë të krijimtarisë së tij ia kishte kushtuar kryeheroit tonë kombëtar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, 600-vjetori i lindjes së cilit po shënohet sivjet. Gjeçovi në veprat e tij e ndjente të nevojshme të evokonte veçanërisht epokën e Gjergj Kastriotit, në mënyrë që të frymëzonte popullin në luftën e tij për liri e pavarësi e për të nxjerrë në pah se "s'u ka tretë fara n'Shqyptarii atyne fatosave qi diin me ndjekun gjurmte e Gjergj kastriotit", siç do të shkruante në "Përparimi", shkurt 1915, faqe 24. Nga veprat e zhanreve të ndryshme të Gjeçovit, figura e Gjergj Kastriotit del madhështore dhe inspiruese për brezet e ndryshme, e veçmas për brezet e reja dhe studiuesitë e veprës së tij.

Në Kosovë u botua për herë të parë drama "Shqyptari ngadhnyes"

Do përmendur se nga 75 vepra, sa na ka lënë trashëgim Atë Shtjefën Gjeçovi, 55 prej tyre ende nuk janë të botuara, gjashtë prej të cilave përkthime, si dhe 20 vepra të tjera janë të botuara kryesisht nga shtëpitë botuese të Kosovës.

Vlen të përmendim rastin se Drejtorati i Kulturës së komunës së Lypianit, ka meritat e veta, sepse në vitin 2002 për herë të parë ka botuar dramën në vargje të Gjeçovit "Shqyptari ngadhnyes", që i kushtohet Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, e të cilën e kishte përgatitur për botim studiuesi Jaho Brahaj nga Tirana.

Atë Shtjefën Gjeçovi e kishte shprehur që të mbante shënime për çdo vepër të lexuar, përkatësisht pas leximit shënonte përshtypjet e tij. Shënime mbi librat e lexuara i bënte bukur. Sa për ilustrim po përmendim shënimin që ka lënë mbi librin "Storia del Medio Evo", botuar në Torino të Italisë në vitin 1913. Po atë vit që ishte botuar kjo vepër Gjeçovi e kishte lexuar. Dhe, në një faqe të këtij libri, si anëshkrim, Gjeçovi shkruan: "Gabim! Kjo nuk munn t'quhet histori e përgjithshme, por e veçantë. Ku është çlirimtari i Pulës, Napolit etj., mbrojtësi i madh i vendit të tij, Gjergj Kastrioti?". Po ashtu, në fund të të njëjtit libër ai shkruan: "Or mik! Ty të hangert dreqi në mjedis t'Itales, po a nuk e paske dijtë ose nuk paske dashtë t'a dijtë se ata romakët tu, për fat të keq kanë pas kenë

edhe në Shqypninë t'onë, por s'kanë kenë të zott me i baa gja, he dreq. Shqypnia asht e rrnoftë dhe ty me të tutë u dekt ora si u ka dekë – në mut”.

Legjenda: **Gjergj Gjon Kastrioti - Skenderbeu**